



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë Melihate Basholli Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së, Jeton Qela, U.d Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erblin Hetemi, U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 11.06.2024 020-386
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Gafurr Sllamniku, Zyrtar i lartë për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,

E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 100/24 për miratimin e propozimit të kryetarit për këmbimin e pronë së paluajtshme të komunës me pronë private për rregullimin e kanalizimit në RR. "Enver Musa" Vushtri

I miratuar më datë: 03.06.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.06.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.